

**VENDIM**  
**Nr. 825, datë 24.12.2021**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË”, TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të shkronjës “c”, të pikës 4, shtohen fjalët “..., në funksion të rritjes së cilësisë dhe formatimit, sipas modeleve të aprovuara të tyre.”.

b) Pas shkronjës “c”, të pikës 4, të shtohen shkronjat “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“ç) ndjekjen e proceseve të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit periodik e të monitorimit të vazhduar të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të tyre të studimit;

d) organizimin dhe nxjerrjen e rezultateve përfundimtare në kuadër të Sondazhit Kombëtar të Studentëve.”.

c) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me propozimin e ministrit përgjegjës për arsimin, me urdhër të Kryeministrit. Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojë të paktën gradën shkencore “Doktor”;

b) të ketë eksperiencë pune mbi 5 (pesë) vjet në institucione që ushtrojnë veprimtari në fushën e arsimit të lartë, duke përfshirë edhe eksperiencë në nivele të larta drejtuese.”.

ç) Në fund të shkronjës “a”, të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Bëhen pjesë e komisioneve të vlerësimit të jashtëm partnerë nga tregu i punës dhe studentë (anëtar i organeve kolegjiale të IAL-ve), pa të drejtë vote, dhe kanë vetëm rol monitorues.”.

d) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 12, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Përjashtëm bëjnë rastet kur në një fushë mungojnë ekspertët dhe duhen angazhuar ekspertë të rinj, që shtojnë listën, por gjithmonë sipas kriterëve dhe në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit.”.

dh) Tabela 2/b, e shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjten numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

---

<sup>1</sup> Ky vendim është përafëruar pjesërisht me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017/C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 prillit 2008, për themelimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të nxënëit gjatë gjithë jetës”.

**Tabela 2/b**  
**Tarifat për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin e programeve të studimit**

<b>Nr.</b>	<b>Programet e studimit</b>	<b>Tarifa</b>
1	2-vjeçar profesional	173 621
2	Bachelor	225 747
3	Bachelor 4-vjeçar	277 874
4	Master profesional 1 vit	173 621
5	Master profesional 2 vjet	225 747
6	Master i shkencave	364 517
7	Master i shkencave i integruar	600 945
8	Master ekzekutiv 1 vit	308 417
9	Master ekzekutiv 2 vjet	364 517
10	SPA 2 vjet	364 517
11	SPA 3–4 vjet	482 731
12	Doktoratë	610 490